



UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEQA"

Syllabusi i lëndës: Kontabiliteti i Kompanive të Sigurimit

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti i Biznesit
Titulli i lëndës:	Kontabiliteti i Kompanive të Sigurimit
Niveli:	Master
Status i lëndës:	Zgjedhore
Viti i studimeve:	I
Numri i orëve në javë:	2+1
Vlera në kredi – ECTS:	6
Koha / lokacioni:	Semestri dimëror
Mësimdhënësi i lëndës:	
Detajet kontaktuese:	
Përshkrimi i lëndës	Lënda Kontabiliteti i Kompanive të Sigurimit është e dedikuar t'i plotësoj njohuritë e studentëve me kontabilitetin e sektorit të sigurimeve. Trajtohen tema të veçanta mbi përgatitjen e raporteve financiare dhe shfrytëzueshmëria nga ana e atyre që marrin vendime afariste.
Qëllimet e lëndës:	Lënda ka për qëllim të plotësoj njohuritë dhe aftësitë e studenteve për përdorimin specifik të koncepteve të kontabilitetit të kompanive të sigurimit. Qëllimi ynë është të tregojmë se si përdoren sot informatat e kontabilitetit në kompanitë e sigurimit.
Rezultatet e pritura të nxënies:	Pas përfundimit të këtij kursi, studentët duhet të jenë në gjendje të: - Shpjegojnë rolin e kontabilitetit në marrjen e vendimeve lidhur me kompanitë e sigurimit; - Të përshkruajnë konceptet themelore të matjeve në pasqyrat financiare të kompanive të sigurimit; - Të zbatojnë interpretimin e raporteve financiare të kompanive të sigurimit.

Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjerata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	1	15	15
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	10	10
Teste, detyra të shtëpisë	2	5	10
Seminare, projekte kërkimore, prezentimet,etj.	2	15	30
Koha e studimit vetanë të studentit	2	15	30
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)	10	1	10
Përgaditja përfundimtare për provim	3	5	15
Totali			150
Metodologjia e mësimdhënies:	• Prezantimi i temës mësimore në Power Point • Përsëritja e temës paraprake nga grupi i caktuar i studentëve, analiza dhe diskutime • Rast studimi apo detyrë (për orën e ushtrimeve) lidhur me temën e ligjëruar		
Metodat e vlerësimit:	• Testi i parë vlerësues: 0 - 30% • Testi i dytë vlerësues: 0 - 30% • Punimi shkencor: 0 - 40% ose • Provimi përfundimtar: 0 - 60%		
Literatura			
Literatura bazë:	▪ Arben Dermaku & Arber Hoti - Kontabiliteti i institucioneve financiare, Prishtinë, 2019. ▪ Peter C. Kattelus - Kontabiliteti për kompanitë e sigurimit, janar 2022.		

Literatura shtesë:	▪ <i>KPMG - Kontabiliteti i sigurimit: Kontratat e sigurimit, 2022.</i> ▪ <i>Robert W. Klein & George A. Zanjani - Kontabiliteti, raportimi dhe rregullimi i sigurimeve: Një pasqyrë gjithëpërfshirëse, 2019.</i>
Plani i dizajnuar i mësimit:	
Java	Ligjerata që do të zhvillohet
Java e parë:	Hyrje (Prezantimi i lëndës, metodat e punës dhe vlerësimit)
Java e dytë:	Njohja me institucionet financiare
Java e tretë:	Sigurimi si koncept
Java e katërt:	Njohja me pasqyrat financiare të kompanive të sigurimit
Java e pestë:	Roli i kompanive të sigurimit në zhvillimin ekonomik
Java e gjashtë:	Trajtimi kontabël i transaksioneve kryesore të kompanive të sigurimit – P1
Java e shtatë:	Trajtimi kontabël i transaksioneve kryesore të kompanive të sigurimit – P2
Java e tetë:	Testi i parë vlerësues
Java e nëntë:	Analiza financiare e kompanive të sigurimit
Java e dhjetë	Përgatitja dhe prezantimi i pasqyrave financiare të kompanive të sigurimit
Java e njëmbëdhjetë:	Pasqyra e pozitës financiare
Java e dymbëdhjetë :	Pasqyra e fitimit ose humbjes
Java e trembëdhjetë:	Pasqyra e ndryshimeve në ekuitet
Java e katërmbëdhjetë:	Pasqyra e rrjedhës së parasë së gatshme
Java e pesëmbëdhjetë:	Testi i dytë vlerësues Prezentimi i punimeve shkencore

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

Cakto politikat e mirësjelljes konform statusit të UHZ-së.

- Para së gjithash, studenti duhet të jetë i ndërgjegjshëm dhe të respektojë institucionin dhe rregullat shkollore;
- Duhet të respektojë orarin e ligjëratave, ushtrimeve dhe të jetë i vëmendshëm në orën mësimore;
- Është i obliguar posedimi dhe paraqitja e indeksit dhe mjetit të identifikimit në teste dhe provim;
- Gjatë hartimit të punimeve seminarike, studenti duhet të përmbahet udhëzimeve të dhëna nga mësimdhënësi për realizimin hulumtues dhe teknik të punimit;
- Testet dhe provimet vlerësohen individualisht për secilin student. Prandaj, studentet duhet të përqëndrohen vetëm në njohuritë personale.
- Shkelja eventuale e këtyre parimeve etike (rregullave) ndëshkohet konform normave të parapara me ligj.